



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr.125, Datë 17.05.2021

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË OST SH.A., PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S, NR. 169, DATË 03.11.2020, PËR SHQYRTIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR VITIN 2020 DHE ATË TË PËRDITËSUAR DHJETËVJEÇAR 2015-2025 TË ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË TRANSMETIMIT TË SHOQËRISË OST SH.A.**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, gërmat “a” dhe “e”, nenit 60, pikat 1, 4 dhe 5, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 6, 7, 8, 10, 11, 12 dhe 13, të Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 135, datë 06.09.2017, si dhe nenit 15 dhe 16, pika 2, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 17.05.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr.70/4 prot., datë 14.05.2021 nga Drejtoritë Teknikë,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 169, datë 03.11.2020, u shpreh në lidhje me kërkesën e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.), për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020 dhe atë të përditësuar dhjetëvjeçar 2015 - 2025 të zhvillimit të rrjetit të transmetimit.
- OST sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 6567 prot., datë 18.11.2020, ka parashtruar në ERE kërkesën për rishikim të vendimit nr. 169, datë 03.11.2020, “Mbi kërkesën e OST sh.a., për shqyrtimin e Planit të investimeve për vitin 2020 dhe atë të përditësuar dhjetëvjeçar 2015-2025 të Zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a”.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 48, datë 15.02.2021, vendosi miratimin e kërkesës së bërë nga ana e OST sh.a., për dorëzimin e dokumentacioneve shtesë nga kjo e fundit brenda 30 ditëve.
- Me qëllim shqyrtimin e planit të investimeve 2020 dhe përditësimin e atij 10-vjeçar 2015 - 2025, si dhe dokumentacionin e përcjellë në vijim të vendimit të ERE-s nr. 48, datë 15.02.2021, ndërmjet përfaqësuesve të ERE-s dhe OST sh.a., në datë 09.04.2021, u realizua një seancë dëgjimore online, në të cilën u parashtruan problematikat e hasura lidhur me shqyrtimin e planit të investimeve 2020 dhe përditësimin e atij 10-vjeçar 2015 – 2025.

- OST sh.a. me shkresën nr. 1760 prot., datë 11.03.2021, me lëndë: *Përcjellje e realizimit të investimeve për vitin 2020*, ka bërë me dije se në kuadër të përgatitjes së raportit vjetor të ERE në zbatim të nenit 25, të ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe vendimit të bordit të ERE-s nr. 48, datë 15.12.2021, ka paraqitur realizimin e investimeve të OST sh.a. për vitin 2020.
  - Lidhur me realizimin e investimeve përgjatë vitit 2020, ku janë evidentuar kontrata dhe investime të cilat janë në vijim nga viti 2020, të cilat janë miratuar vitet e mëparshme, në konstatimet e vendimit të bordit të ERE-s nr. 169, datë 03.11.2020, parashtrohet se: *“Investimet e miratuara nga ERE në vitet e mëparshme me financim nga fondet e shoqërisë të cilat vijojnë implementimin e tyre përgjatë vitit 2020 duhet të vijojnë të kryhen pasi janë të miratuara nga ERE në vitet respektive. Për investimet të cilat janë në implementim të miratuara nga ERE në vitet e mëparshme, OST sh.a. duhet të raportojë periodikisht në ERE në mënyrë që të kryhet monitorimi i ecurisë së realizimit të tyre përgjatë vitit 2020.”*
  - Lidhur me investimet e realizuara nga OST sh.a. me fonde të huaja për vitin 2020, në konstatimet e vendimit të bordit të ERE-s nr. 169, datë 03.11.2020, parashtrohet si me poshtë vijon: *“Vlera totale e investimeve parashikuar nga OST sh.a. për t’u realizuar në vitin 2020, me financime të huaja është 1,418,857,364 lekë, (për t’u disbursuar nga kreditë) dhe investime për t’u financuar nga OST sh.a. si kosto lokale në vlerën 90,911,434 Lekë, si dhe grante 72,330,896.11 Lekë. Këto investime janë në proces realizimi nga OST sh.a. dhe përgjatë vitit 2020 pasi janë projekte të miratuara nga ERE në vitet respektive. ERE ka dhënë miratimet përkatëse për këto investime/projekte në miratimin e planeve të investimit të OST sh.a. në vitet e mëparshme. OST sh.a., të vijojë me realizimin e tyre dhe të raportojë periodikisht në ERE mbi ecurinë e realizimit të tyre”.*

Sikurse evidentuar më sipër, investimet të cilat vijojnë nga vitet e mëparshme dhe ato të realizuara në fonde të huaja janë të miratuara nga ERE dhe duhet të vijojnë të realizohen nga OST sh.a., deri në përfundimin e tyre.

- Me shkresën nr. 1732 prot., datë 10.03.2021, me lëndë *“Përcjellje dokumentacioni në vijim të vendimit nr. 48, datë 15.02.2021, të bordit të ERE-s”*, OST sh.a., ka përcjellë në ERE Raportin e fundit të Konsulentit, të përditësuar për herë të dytë, pas reflektimeve të komenteve të OST sh.a., të *“Planit mbi investimet dhe zhvillimin e rjetit për Sektorin e transmetimit të energjisë në Shqipëri për vitet 2018-2033”*.
  - OST sh.a. nëpërmjet shkresës nr. 2924/1 prot., datë 10.05.2021, në përgjigje të shkresës së ERE-s, nr.446/1, datë 28.04.2021 *“Lidhur me seancën dëgjimore të realizuar ndërmjet përfaqësuesve të ERE dhe OST sh.a., mbi planin e investimeve të OST sh.a.”*, ka vënë në dispozicion të ERE-s:
    1. Tabelën në të cilën është pasqyruar ndarja e zërave dhe vlerave të realizimit të investimeve me fondet e veta të OST sh.a., duke evidentuar ecurinë e realizimit të investimeve në referencë të miratimeve të mëparshme të ERE-s si dhe evidentimi i listës së investimeve të reja të programuara/në proces realizimi/proces prokurimi të vitit 2020;

2. Tabelën në të cilën është pasqyruar lista e projekteve të reja të parashikuara/në proces realizimi/proces prokurimi të vitit 2020.
- Në tabelën e përcjellë nga OST sh.a. jepen investimet të cilat ishin parashikuar nga kjo e fundit për vitin 2020, ndër këto investime konstatohet se për një pjesë të tyre nuk ka filluar procesi i realizimit.
  - Duke qenë se jemi në vitin 2021, për investimet të cilat janë parashikuar për vitin 2020 dhe nuk kanë filluar procesin e realizimit, vlerësohet se këto zëra investimesh OST sh.a., duhet t'i riskedulojë për t'i realizuar dhe për t'i përfshirë në vitet vijuese.
  - Gjithashtu, nga krahasimi i dy tabelave të vëna në dispozicion nga ana e OST sh.a., rezulton që zërat e mëposhtëm të investimeve nuk janë as në proces realizimi, as në proces prokurimi:
    - i. *Instalimi hardware dhe implementimi logjikës PLC mbi menaxhimin e LFC në lidhje me sistemet lokale të kontrollit të përdoruesve të rrjetit të OST sh.a. me vlerë 12,990,000 lekë.*
    - ii. *Integrim i dy trakteve 220 kV në nënstacionet Elbasan 1 dhe Elbasan 2 (trakti i TR2 dhe trakti i Kurum). Me vlerë 11,970,000 Lekë.*
    - iii. *Integrimi i linjave të interkonjeksionit nga WAMS në modulën e rregullimit sekondar me vlerë 5,000,000 Lekë.*
    - iv. *Përmirësimi i infrastrukturës qendrore, platformat dhe sistemeve TI, me vlerë 15,000,000 Lekë.*
    - v. *Sistem i matjes online, me vlerë 8,000,000 Lekë.*
    - vi. *Sistem për menaxhimin e projekteve dhe detyrave, me vlerë 6,500,000 Lekë.*
    - vii. *Hostim dhe Anycast për website dhe ndërfaqësim me platformat kryesore të OST sh.a., me vlerë 2,500,000 Lekë.*
    - viii. *Instalimi i trosit OPGW në linjën 154 Kv Bistricë-Kufi, pa vlerë financiare në tabelën ku jepet vlera e Investimit.*
    - ix. *Furnizimi, instalimi dhe konfigurimi i 2 sistemeve online të izolatorëve dhe shkarkimeve pjesore TR e fuqisë AT1 dhe AT2 në n/st 220/110/10 kV Burrel, pa vlerë financiare në tabelën ku jepet vlera e investimit.*
  - Duke qenë se këto zëra investimesh nuk janë në proces realizimi/prokurimi, vlerësohet se OST sh.a. duhet të riskedulojë këto zëra investimesh në vitet në vijim.
  - Në të njëjtën kohë investimi me zërin: Instalimi i trosit OPWG në linjën 154 kV Bistricë-Kufi, është pa vlerë financiare në tabelën ku jepet vlera e investimit, por vetëm vlera e kontratës.
  - Bordi i ERE-s me vendim nr. 194, datë 03.12.2019, “Mbi opinionin e ERE-s për kërkesën e OST sh.a., për dhënie në përdorim të një pjese të infrastrukturës së fibrës optike”, në pikën 1, gërma “b”, e këtij vendimi ka vendosur që: “Kostot për realizimin e këtij aktiviteti të mbuloohen nga të ardhurat e realizuara nga kjo duke mos ndikuar në tarifën e transmetimit të energjisë elektrike, si dhe në kostot e lidhura me këtë shërbim ndaj klientëve fundorë”. Në këto kushte ky investim që

lidhet posaçërisht me fibrën optike, që mbulohet nga tarifa e OST sh.a. bie ndesh me vendimin e bordit të ERE-s, sipërcituar, dhe për rrjedhojë nuk do të pranohet.

- Investimi me zërin Furnizimi, instalimi dhe konfigurimi i 2 sistemeve online të izolatorëve dhe shkarkimeve pjesore TR e fuqisë AT1 dhe AT2 në n/st 220/110/10 kV Burrel, është pa vlerë financiare në tabelën ku jepet vlera e investimit, por vetëm me vlerën e kontratës. ERE nuk miraton vlerat e kontratës, por vlerën e parashikuar të investimit dhe duke qenë se nuk ka një vlerë të tillë në tabelën e përcjellë nga OST sh.a., me shkresën nr. 2924/1 prot., datë 10.05.2021, vlerësohet se ky investim i paraqitur në këtë formë nuk mund të pranohet për shqyrtim.
- Nga krahasimi i tabelave rezulton se investimet e paraqitura nga OST sh.a., në proces realizimi/prokurimi janë pjesë e investimeve të trajtuara me vendimin nr. 169, datë 03.11.2020.

**Sikurse evidentuar më sipër vlerësimi do të realizohet vetëm për ato investime të cilat janë në proces realizimi ku përfshihet dhe procesi i prokurimit. Investimet të cilat nuk janë në këtë proces duhet të riskedulohen nga OST sh.a. për vitet vijuese.**

- Studimi i rrjetit 110 kV të rajonit midis Elbasanit dhe Korçës, Studimi i problemeve të sistemit elektroenergjetik në kushtet e gjenerimit maksimal të vendit dhe fuqizimi i rrjetit të transmetimit në zonën verilindore, si dhe Drafti i metodologjisë së vlerësimit kosto-përfitim të projekteve të rrjetit shqiptar të transmetimit.
- **Lidhur me Studimin e rrjetit 110 kV të rajonit midis Elbasanit dhe Korçës:**
  - Në këtë studim evidentohet nevoja e fuqizimit të rrjetit 110 kV në zonën e Elbasanit, Librazhdit dhe të Korçës.
  - Rrjeti ekzistues 110 kV në rajonin midis Elbasanit dhe Korçës, paraqet një rrjet mjaft të amortizuar dhe me kapacitet të ulët transmetimi që e vështirëson planifikimin e lidhjes së burimeve të reja gjeneruese. Pasojë e kësaj situate janë:
    1. Kufizimi i prodhimit në periudha të favorshme hidrologjike,
    2. Ndërprerje të shpeshta për shkak të dëmtimeve në rrjet,
    3. Humbje të larta të fuqisë në rrjetin 110 kV,
    4. Kufizimi i kërkesave për lidhje në rrjetin e transmetimit të burimeve të reja në këtë zonë.
  - Rehabilitimi i rrjetit 110 kV në këtë zonë është i domosdoshëm. Si rezultat i studimit të kryer, varianti më i mirë i analizuar është ai që merr në konsideratë fuqizimin e traktit Elbasan - Librazhd me linjë të re dyfishe me përcjellës ACSR-240/40 mm dhe të traktit Librazhd - Korçë me linjë njëfishe me përcjellës ACSR240/40 mm.
  - Rehabilitimi do të eliminojë mbi ngarkimet dhe do të ketë një impakt në zvogëlimin e humbjeve të fuqisë, përmirësimin e profilit të tensionit dhe funksionimin normal të të gjithë rrjetit 110 kV të zonës.
- **Lidhur me Studimin e problemeve të sistemit elektroenergjetik në kushtet e gjenerimit maksimal të vendit dhe fuqizimit të rrjetit të transmetimit në zonën verilindore.**

- Në këtë studim parashtrohet se: *Mbingarkimi i rrjetit 110 kV të zonës Verilindore. Zona verilindore përfshin një hapësirë relativisht të madhe, ku vitet e fundit janë ndërtuar një numër i madh i HEC-esh lokale. Kjo zonë ka një potencial të madh hidrik dhe një numër relativisht të madh HEC-sh janë në proces ndërtimi. Rrjeti unazor 110 kV ndërmjet nënstacioneve 220/110 kV Fierzë dhe 220/110 kV Burrel që shtrihet në zonën verilindore ka një gjatësi të përgjithshme prej rreth 150 km, i ndërtuar kryesisht gjatë viteve 1967-1969, me pjesën më të madhe të segmenteve me përcjellës AC 95 mm.*
- Në pjesën e ndërhyrjeve të planifikuara të këtij studimi parashtrohet se: *Rrjeti 110 kV i zonës Verilindore dhe trakti 110 kV Elbasan - Korçë janë dy zona ku ndërhyrjet për fuqizimin e rrjetit janë tashmë emergjente. Referuar situatës aktuale dhe HEC-eve në fazë ndërtimi të planifikuar për t'u lidhur së shpejti në rrjetin 110 kV (68 MW) dhe në rrjetin e shpërndarjes (186 MW), OST ka identifikuar problemet dhe ka përcaktuar ndërhyrjet afatshkurtra të domosdoshme që duhen realizuar.*
- OST sh.a., në këto studime ka parashtruar se këto projekte ndikojnë në përmirësimin e sigurisë së rrjetit të transmetimit, si dhe kanë parashtruar elementë të analizave ekonomike dhe financiare që lidhen me analizën kosto-përfitim.
- **Lidhur me Draftin e Metodologjisë së vlerësimit kosto - përfitim të projekteve të rrjetit shqiptar të transmetimit.**
  - OST sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 6967/2 prot., datë 21.12.2020, ka përcjellë në ERE, Draftin e metodologjisë së vlerësimit kosto-përfitim të projekteve të rrjetit Shqiptar të transmetimit.

**Drafti i Metodologjisë së vlerësimit kosto-përfitim të projekteve të rrjetit shqiptar të transmetimit duhet të finalizohet dhe në vijim OST sh.a., të realizojë analizën Kosto përfitim për projektet që do të realizojë në sistemin e transmetimit.**

- OST sh.a. nëpërmjet shkresës nr. 1732 prot., datë 10.03.2021, ka përcjellë gjithashtu si provë të re në ERE, raportet e studimit të para-fizibilitetit për tre projekte (Three Pre-Feasibility Study Reports).
- **Lidhur me Përditësimin e Planit dhjetëvjeçar 2015-2025 të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a.**
  - OST sh.a. nëpërmjet shkresës nr. 1732 prot., datë 10.03.2021, ka përcjellë Draftin e Raportit të fundit të konsulentit, të përditësuar për herë të dytë, pas reflektimeve të komenteve të OST, të “Planit mbi investimet dhe Zhvillimin e rrjetit për Sektorin e transmetimit të energjisë në Shqipëri për vitet 2018 – 2033”.
  - OST sh.a. parashtron se Plani mbi investimet dhe Zhvillimin e rrjetit për Sektorin e transmetimit të energjisë në Shqipëri për vitet 2018-2033, është aktualisht në pritje të marrjes së konfirmimit nga institucionet financiare ndërkombëtare të cilat e kanë financuar këtë projekt, respektivisht banka Gjermane KFW. Finalizimi i këtij drafti është element thelbësor për të bërë rishikimet e nevojshme në planet afatgjate të zhvillimit.

- OST do të përditësojë Planin 10 vjeçar për periudhën 2015-2025, miratuar me vendimin nr. 212, datë 28.12.2017

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të pranojë kërkesën e OST sh.a., për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s, nr. 169, datë 03.11.2020, “Për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020 dhe atë të përditësuar dhjetëvjeçar 2015-2025 të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a”.
2. Miratimin e planit të investimeve të shoqërisë OST sh.a., për vitin 2020, sipas tabelës bashkëlidhur në shtojcën A, në vlerën 3,572,899,242 lekë.
3. OST sh.a., të përditësojë pjesën e mbetur të planit 10 vjeçar për periudhën 2015-2025, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 212, datë 28.12.2017, sipas kriterëve të përcaktuara në *“Rregulloren e procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 135, datë 06.09.2017 dhe të raportojë në ERE për realizimin e investimeve të vitit 2020, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
4. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë OST sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**

## SHTOJCA A

| Nr.  | Lista e Projekteve  | Vlera e Investimit   |
|--|---|----------------------|
| <b>Lista e Investimeve te Reja per tu realizuar gjate vitit 2020 (per Miratim nga ERE)</b> |   |                      |
| 1  | Përforcimi i linjes 110kV, Cerrik-Kajan-Kucove-Jagodine   | 600,000,000          |
| 2  | Ndertimi i linjes re me dy qarqe 110 kV Burrel - Bulqize  | 650,000,000          |
| 3  | Linje e re 110kV, Fier -Lushnje   | 250,250,250          |
| 4  | Ndertimi i linjes re me dy qarqe 110 kV Elbasan-Fiber   | 194,000,000          |
| 5  | Rehabilitimi I dy linjave 110 kV Elbasan - Cerrik   | 212,000,000          |
| 6  | Zgjerimi i sistemit te lokalizimit te defekteve ne Linjat e Tensionit te Larte  | 99,730,002           |
| 7  | Pajisje per mirembajtjen e nenstacioneve  | 90,000,000           |
| 8  | Punime civile per trakte 110 kV ne Njesit Operative   | 60,000,000           |
| 9  | Rikonstruksioni linjes 110 kV Ulez-Burrel perfshi dhe ljerjen e shtyllave   | 60,000,000           |
| 10   | Blerje pajisje elektrike për riparimin e defektit për normalizimin e funksionimit të sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit të TR2 150 MVA dhe monitorimit online | 2,416,000            |
| 11   | Spostimi i linjës ajrore 220 kV dopjo qark Tirana 2-Elbasan 2   | 28,090,090           |
| 12   | Mbikqyrja e punimeve per investimet   | 45,000,000           |
| 13   | Blerje 2 seteve të sistemit të monitorimit online BMT   | 34,890,000           |
| 14   | Blerje license USB per program kompjuterik PSS/E per analizen e rrjetit   | 4,157,500            |
| 15   | Upgrade , mirembajtje dhe trajnim per sistemin qendror SCADA/EMS (për një periudhë 4 vjecare)   | 350,000,000          |
| 16   | Zgjerimi i monitorimit ne Qendren Emergjente te Kontrollit me Nst 110kV te rehabilituara dhe komandimi i tyre nga NDC.  | 23,942,300           |
| 17   | Perditesimi i moduleve, topologjise dhe analizave per aplikacionet e rrjetit EMS  | 17,800,000           |
| 20   | Blerja e licencave per software-in e menaxhimit te llogjikes se PLC ne RTU e implementuara ne HEC-e dhe Analizatorit te Protokolleve.                           | 4,788,100            |
| 22   | Permiresim i rrugeve te komunikimit Sistem Lokal – Rele (mbrojtje, kontrolli).  | 4,720,000            |
| 23   | Zhvillimi dhe mirembajtja e sistemit DAMAS  | 28,275,000           |
| 24   | Përmisimi i infrastrukturës së rrjetit dhe rritja e sigurise brenda infrastrukturës TI  | 22,500,000           |
| 26   | Implementimi i një sistemi backup dhe disaster recovery   | 11,440,000           |
| 27   | Pajisje TI, Kompjuter PC, Laptop, Printer, etj.   | 8,900,000            |
| 31   | Lidhja e OST me shtetet fqinje me paisje DWDM (Pregatitja e planit dizenjimi dhe upgrade DWDM)  | 37,500,000           |
| 32   | Vegla pune per mirembajtjen e rrjetit OPGW 6 sete per NJO   | 12,500,000           |
| 33   | Investim ne aksione per krijimin e Burses Energjitike   | 250,000,000          |
| 34   | Ndertimi i linjes me dy qarqe 110 kV dhe nje qark ne pune Librazhd -Perrenjas   | 310,000,000          |
| 35   | Blerje Transformatori 63 MVA , 220/20 kV per N/St e Tirana 1  | 160,000,000          |
| <b>Totali i Realizimit te Investimeve te Reja te parashikuara gjate vitit 2020</b>         |   | <b>3,572,899,242</b> |

**Tabela e Investimeve OST sh.a. viti 2020.**